

20240741575

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MEDIA

Neni 1

Në Ligjin e Medias (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 184/13, 13/14 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 63/24), në nenin 28-a, paragrafi (4), ndryshon si vijon

(4) Mediave të shtypit të përditshme që botohen në gjuhën maqedonase, u ndahen mjete në shumë prej 50% për shpenzimet e bëra të shtypit dhe në shumë prej 50% për shpenzimet e bëra të shpërndarjes, kurse mediave të shtypura të përditshme që botohen në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të cilën e flasin pjesëtarët e bashkësive që janë së paku 20% ose më pak se 20% e popullsisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të garantuar me Kushtetutë, në shumë prej 70% për shpenzimet e bëra të shtypit dhe në lartësi prej 70% për shpenzimet e bëra të shpërndarjes. Mjetet në shumë prej 70% për shpenzimet e bëra të shtypit dhe 70% të shpenzimeve të bëra të shpërndarjes do t'u ndahen edhe mediave të shtypit javore, mujore dhe lokale, sipas faturave të dorëzuara për vitin paraprak kalendarik”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.